



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 400-01/29974/4, dt. 29. Maj 2025.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28, datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.1. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimën e mbajtur me datë: 29. Maj 2025, në propozim të komisionit të kuvendit dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 42/2025

**Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Pejës,
Znj. Rosaria Succurro**

1. Znj. Rosaria Succurro, shtetase e Republikës së Italisë, i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Komunës së Pejës, me motivacion:

"Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm duke qenë ura kryesore e lidhjes me komunitetin arbëreshë si Presidente e Provincës së Kozencës, provincë kjo më e madhe e populluar me arbëreshë me gjithsejtë 28 komuna të cilat i kanë rezistuar kohës shekullore për ruajtjen e gjuhës, traditës, zakoneve dhe kulturës arbëreshe në Italinë Jugore".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj